



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel 04 22268141; 22268142

Nr. 55/6 Prot.

Tiranë, më 13.07.2017

**V E N D I M**

Nr.160, datë 13/07/2017

***"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 5, datë 31.01.2017, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin, Drejtoria e Bujqësisë Fier"***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe Rregulloren, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 5, datë 31.01.2017, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin, Drejtoria e Bujqësisë Fier",

**VËREJ SE:**

Me Vendimin nr. 138, datë 30.12.2015, "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe në institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil", Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka filluar mbikëqyrjen e përgjithshme në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil. Bazuar në këtë vendim ka vijuar mbikëqyrja edhe në institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Fier. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 5, datë 31.01.2017, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin, Drejtoria e Bujqësisë Fier", në të cilin është vendosur:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Drejtorinë e Bujqësisë Fier, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.

2. Njësia e burimeve njerëzore në institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Fier, në kuptim të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar dhe të Vendimit nr.116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktuale që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, duhet të administrojë në dosjen e personelit të nëpunësit \*\*\*\*\*, me detyrë "Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Fier", diplomën e përfundimit të programit të studimeve "Master i Shkencave", në rrethanat kur, afati i përcaktuar në ligj për plotësimin e kriterit të nivelit të diplomës, ka përfunduar.

Një kopje e dokumenteve, të cilët duhet të jenë origjinale ose fotokopje të vërtetuara nga noteri, duhet t'i dërgohet Departamentit të Administratës Publike, i cili duhet të vijojë me përfundimin e procedurës së deklarimit të statusit të punësimit për punonjësin \*\*\*\*\*.

3. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, në zbatim të neneve 108, 110 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", në cilësinë e eprori direkt, të anulojë aktin administrativ nr. 18/1, datë 16.4.2015, për konfirmimin si "nëpunës civil" në pozicionin "Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Fier", të nëpunësit \*\*\*\*\* , si një akt absolutisht i pavlefshëm.

4. Njësia e burimeve njerëzore e institucionit, të përfundojë procesin e hartimit të përshkrimeve të punës, për të gjitha pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në Vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", të ndryshuar dhe sipas orientimeve në Raportin Përfundimtar të Mbikëqyrjes, duke e vijuar këtë proces si më poshtë:

- Të kërkojë zyrtarisht mendimin e Departamentit të Administratës Publike, për vlerësimin e ligjshmërisë së formularit të përshkrimit të punës për çdo pozicion pune në shërbimin civil, nëse është në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar.
- Pas marrjes së konfirmimit nga njësia përgjegjëse (DAP), të vijojë procesi me miratimin dhe nënshkrimin e përshkrimeve të punës, nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, në ndarjen përkatëse, siç parashikohet në pikën 18, shkronja "c", të Vendimit nr.142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave.
- Pas miratimit, nënshkrimit dhe dokumentimit të përshkrimeve të punës, një kopje e tyre, të bëhet pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil dhe një kopje të depozitohet pranë Departamentit të Administratës Publike.

5. Për të rregulluar ligjshmërinë e procesit të ristrukturimit në institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Fier, njësia përgjegjëse (DAP), në kuptim të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar dhe nenit 111, 113, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", në lidhje me punonjësit \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* , të cilët janë transferuar në pozicione jashtë shërbimit civil, duhet të anulojë pjesërisht aktin nr. 2893/1, datë 24.6.2015, "Mbi transferimin e disa nëpunësve për shkak të ristrukturimit të Drejtorisë së Bujqësisë Fier", duke vepruar si më poshtë:

- *Të anulohet pika 3, 4 dhe 5, e aktit administrativ nr. 2893/1, datë 24.6.2015, “Mbi transferimin e disa nëpunësve për shkak të ristrukturimit të Drejtorisë së Bujqësisë Fier”, në lidhje me transferimin e punonjësve \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* në pozicionin e punës, “Specialist”, pranë Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural.*
  - *Njësia përgjegjëse, të nxjerrë aktet individuale të lirimimit nga shërbimi civil, për punonjësit \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* për shkak të përfundimit të marrëdhënies së punës, në kuadër të ristrukturimit të Drejtorisë së Bujqësisë Fier.*
  - *Në kuptim të nenit 50, pika 8, shkronja “a”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, t’u njohë punonjësve \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* të drejtën që brenda periudhës 2-vjeçare, nga data e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, të konkurrojnë si nëpunës civilë për procedurën e lëvizjes paralele apo të ngritjes në detyrë, në pozicione pune të shërbimit civil dhe të njoftohen punonjësit për këto akte.*
6. *Njësia e burimeve njerëzore të institucionit, për të ndrequr parregullsinë e konstatuar në lidhje me përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të dorëheqjes në rastin e nëpunëses \*\*\*\*\* duhet të veprojë si më poshtë:*
- *Të plotësojë dosjen e personelit me kërkesën me shkrim për dorëheqje nga nëpunësja \*\*\*\*\*.*
  - *Akti i lirimimit nga shërbimi civil për shkak të dorëheqjes, t’i njoftohet zyrtarisht Departamentit të Administratës Publike, si njësia përgjegjëse për administrimin e shërbimit civil në këtë rast, me qëllim vazhdimin e procedurave të mëtejshme që kanë të bëjnë me të drejtën e nëpunëses \*\*\*\*\* për të konkurruar për lëvizje paralele, apo ngritje në detyrë, për një periudhë 2-vjeçare, që fillon nga data e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil.*
7. *Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore e institucionit, të plotësojë dosjen e personelit të çdo nëpunësi civil, duke përfshirë në të, të gjitha dokumentet dhe të dhënat sipas lidhjeve 1 e 2, pjesë e Vendimit nr. 117, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, si dhe ato të evidentuara në mungesë në tabelat aneks, të cilat janë pjesë e Raportit Përfundimtar të Mbikëqyrjes.*
8. *Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 30 ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e Raportit Përfundimtar të Mbikëqyrjes.*

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmërues Nr. 5, datë 31.01.2017, të Komisionerit, me vendimin Nr.147, datë 30.06.2017, “Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr.5, datë 31.01.2017, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të

*shërbimit civil në institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Fier”, ka vendosur fillimin e verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 5, datë 13.12.2017, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin, Drejtoria e Bujqësisë Fier”.*

Për këtë qëllim u ngrit grupi i punës, me përbërje Ilirjan Osmanlliu dhe Joni Marko, me detyrë Specialistë në Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të cilët në datën 04.07.2017, u paraqitën pranë institucionit, Drejtoria e Bujqësisë Fier.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Fier, dhe subjekti u njoftua për fillimin e procesit me shkresën nr. 1345/2 prot., datë 30.06.2017, “Njoftim për fillimin e verifikimit”.

Grupi i punës, gjatë vizitës në subjekt komunikoi me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe verifikoi materialet shkresore të cilat vërtetohin zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në vendimin paralajmërues. Takimi me njësinë e burimeve njerëzore, si dhe verifikimi i akteve dhe dokumentacionit shoqëruar që administrohej nga kjo zyrë dhe zyra e Arkiv-Protokollit, është materializuar në procesverbalin e datës 04.07.2017, të mbajtur nga grupi i punës i Komisionerit dhe personi i kontaktit i institucionit, Drejtoria e Bujqësisë Fier, specialisti për burimet njerëzore.

Pasi u administruan dhe u trajtuan materialet shkresore, të vëna në dispozicion, rezultoi se:

- Në zbatim të pikës 2 të vendimit, Njësia e Burimeve Njerëzore të institucionit, me shkresën nr.59, datë 07.02.2017, i ka dërguar Departamentit të Administratës Publike, dokumentacionin për rastin e Drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë Fier, \*\*\*\*\* duke i bërë me dije mosplotësimin e kriterit të nivelit të diplomës prej tij, në kushtet kur afati i përcaktuar në ligj për plotësimin e këtij kriteri ka përfunduar (*kërkohet diploma e përfundimit të programit të studimeve “Master i Shkencave”*). Në momentin e verifikimit, nga ana e Departamentit të Administratës Publike nuk është kthyer përgjigje në lidhje me shkresën e sipërcituar.

Referuar pikave 6/1. dhe 6/2. të Kreut III të Vendimit Nr. 116, datë 05.03.2014, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar:

*“6/1. Punonjësit e institucioneve të varësisë, pjesë e administratës shtetërore, të cilët bëhen pjesë e shërbimit civil, si pasojë e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, dhe që në momentin e deklarimit të statusit nuk plotësojnë kriterin e nivelit të diplomës së arsimit të lartë, të pozicionit të punës ku janë të emëruar, të vazhdojnë të punojnë në pozicionet ku janë të emëruar, me kushtin që, brenda një afati 2-vjeçar, t’i plotësojnë këto kushte.*

*6/2. Për punonjësit, të cilët nuk i plotësojnë kushtet, sipas pikës 6/1, të kreut III, të këtij vendimi, në përfundim të afatit të mësipërm, Departamenti i Administratës Publike njofton njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit përkatës, i cili vendos përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këta punonjës.”*

Sa më sipër, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Drejtorisë së Bujqësisë Fier nuk ka vendosur ende përfundimin e marrëdhënies së punësimit për punonjës

\*\*\*\*\*, pasi është në pritje të njoftimit nga njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike.

- Në lidhje me rekomandimin për anulimin nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (në cilësinë e eprorit direkt – pika 3 e vendimit të Komisionerit) të aktit administrativ për konfirmimin si nëpunës civil në pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Fier*”, të nëpunësit \*\*\*\*\* si një akt absolutisht i pavlefshëm, nuk ka ende asnjë reagim nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të kësaj ministrie.
- Në zbatim të pikës 4 të vendimit, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ka hartuar përshkrimet e punës për të gjitha pozicionet e shërbimit civil. Me shkresën nr.91, datë 02.03.2017, “*Dërgimi i formularëve të përshkrimit të punës*”, formularët e përshkrimit të punës i janë dërguar Departamentit të Administratës Publike, që të vlerësojë nëse ata janë hartuar në bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar, siç përcaktohet në pikën 19, të Vendimit Nr.142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”. Në momentin e verifikimit, nga ana e Departamentit të Administratës Publike nuk është kthyer përgjigje në lidhje me shkresën e sipërcituar.

Me shkresën nr.73, datë 14.02.2017, praktika e mësipërme i është dërguar edhe Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

- Në pikën 5 të vendimit të Komisionerit i është lënë detyrë Departamentit të Administratës Publike që të rregullojë ligjshmërinë në rastin e punonjësve \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* të cilët janë transferuar në pozicione jashtë shërbimit civil pranë Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural. Në momentin e verifikimit, rezulton se, ka ndryshuar regjimi juridik i marrëdhënies së punës për nëpunësit e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, duke i përfshirë ata përsëri në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil.

Në rastin konkret, ky ndryshim, është pasqyruar në Vendimin nr. 877, datë 14.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 719, datë 31.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”*”, ku përcaktohet:

- Pika 9: “*Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të AZHBR-së rregullohen në bazë të legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë të AZHBR-së, rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës*”.
- Pika 17: “*Për nëpunësit aktualë të AZHBR-së zbatohen dispozitat e nenit 67, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar*”.

Për të vënë në zbatim këto ndryshime, sipas pikës 5, të vendimit të sipërcituar, është ngarkuar Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, si dhe Departamenti i Administratës Publike.

Në këtë rast, duhet të mbahet parasysh nga njësia përgjegjëse fakti, që këta nëpunës, e gëzojnë statusin e nëpunësit civil që në momentin e deklarimit të tyre pranë Drejtorisë së Bujqësisë Fier, sipas interpretimit që është bërë më lart nga Komisioneri. Ky fakt vlen për të përcaktuar kohëzgjatjen e punësimit të këtyre punonjësve në pozicionin e punës ku ata kryejnë detyrën, në momentin e deklarimit të statusit të punësimit pranë Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural.

- Në zbatim të pikës 6 të vendimit, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, ka plotësuar dosjen e punonjës Natasa Shukulli me kërkesën e saj me shkrim, të datës 14.07.2015 për dorëheqje nga detyra “*Specialiste Veterinere*” dhe me aktin e lirimit të saj nga shërbimi civil nr.218/1, datë 17.07.2015. Me shkresën nr.60, datë 07.02.2017, këto akte i janë njoftuar Departamentit të Administratës Publike për vazhdimin e procedurave të mëtejshme në lidhje me këtë punonjëse.
- Në lidhje me zbatimin e rekomandimit të pikës 7 të vendimit të Komisionerit, gjatë verifikimit në subjekt rezultoi se dosjet e personelit ishin plotësuar sipas përcaktimeve të vendimit nr.117, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*” (në cilësinë e provës grupi i verifikimit ka administruar një dosje të plotë që provon sa më sipër)

Për sa u përket më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin nr. 5, datë 31.01.2017, “*Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin, Drejtoria e Bujqësisë Fier*”, të Komisionerit, rezulton se nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit janë zbatuar të gjitha rekomandimet e lëna në vendimin paralajmërues. Aktualisht pritet reagimi respektivisht i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave për anulimin e aktit administrativ për konfirmimin si nëpunës civil në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Fier”, të nëpunësit \*\*\*\*\* dhe i Departamentit të Administratës Publike për:

- Njoftimin sipas pikës 6/2 të Kreut III të Vendimit Nr. 116, datë 05.03.2014, “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për rastin e punonjësit \*\*\*\*\* (pas marrjes së të cilit, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit duhet të procedojë me përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këtë punonjës).*
- Anulimin nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të aktit administrativ për konfirmimin si nëpunës civil në pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Fier*”, të nëpunësit \*\*\*\*\*.
- Konfirmimin nëse përshkrimet e punës janë hartuar në bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar.
- Vënien në zbatim të ndryshimeve në regjimin juridik të marrëdhënies së punësimit për punonjësit e transferuar pranë Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural.

#### **Për këto arsye:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” dhe

Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

**VENDOSA:**

1. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Drejtorisë së Bujqësisë Fier, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit Nr. 5, datë 31.01.2017, “*Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin, Drejtoria e Bujqësisë Fier*”.
2. Verifikimin e mëtejshëm të pikave 2, 3, 4 dhe 5 të dispozitivit të Vendimit Nr. 5, datë 31.01.2017, për të cilën kërkohet reagimi i Njesisë Përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Drejtorisë së Bujqësisë Fier, Departamenti i Administratës Publike, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**